

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Pas Shkolle"/ 408 institucione në program: Detyra, muzikë, teatër dhe artizanat deri në orën 15:00
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/pas-shkolle-408-institucione-ne-program-detyra-muzike-teater-dhe-artizan-i584307
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 13:38:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 14:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a9a33c97197caf5312c4c048d17ea5c6305e4cd95e91f9a6b20ff006086b7400
TEKSTI	3bf7b630c9d16f048de833e528ce98b53d1ba914a12547406df7d8dd4b4d4fe4
PAMJA	abb38f5dc0014d60fb804371251da278ec7029417db4daebbeba96c0f06bfb91

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	50c15a2bed75c650dc05c4bad84c07893a504cb91f8ab51a8da4a3155afe41c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b153b854c154dd4d6c3613e7c633ddb6afc042e1cebe995d4321c2de8150c895
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/50c15a2bed75c650dc05c4bad84c07893a504cb91f8ab51a8da4a3155afe41c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Rusia mohon përshirjen ne dronin me eksplozive, Lavrov: Kjo eshte rruga drejt nje lufte te vertete](#)"Pushteti eshte nje katshe e perbindshme" - Rama per Ilir Meten: E tuti fundit

“Pas Shkolle”/ 408 institucione në program: Detyra, muzikë, teatër dhe artizanat deri në orën 15:00



6 Shtator 2026, 16:55Sociale TEMA



Pas ziles së fundit, nxënësit në shkolla do të vijojnë me detyra, muzikë, teatër, kërcim dhe artizanat. Ministria e Arsimit ka përzgjedhur tashmë 408 institucione për zbatimin e programit “Pas Shkolle”.

“Kemi përgatitur 408 institucione, të cilat do të mirëpresin programin dhe zbatimin e fashave dhe klubeve të caktuara sipas shkollave. Janë përzgjedhur në varësi të kushteve, ambienteve dhe në përshtatje me interesat dhe kërkesat e nxënësve”, tha Herida Duro, zv.ministre e Arsimit.

Programi do të shtrihet në të gjithë ciklin parauniversitar, ndërsa aktivitetet do të ndryshojnë sipas grupmoshave.

“Nga klasa e parë deri në të pestën, nxënësit do të përfitojnë dy module: të bërit e detyrave dhe përmirësimit e njohurive të tyre, por edhe modulën e arteve dhe zejeve, në disiplinën si teatri, muzika, kërcimi, artet figurative dhe artizanati”, shtoi Duro.

Në program do të angazhohen mësues të ciklit fillor, mësues në pritje në portal, mësues në pension, të sapodiplomuar, si dhe artistë e trajnerë të fushave përkatëse.

“Pagesa, 1 mijë lekë ora, besojmë se do të bëjë të mundur rekrutimin e një pjese të mirë të të sapodiplomuarve dhe të artistëve të rinj”, tha ajo.

Programi, sipas zv. ministres së Arsimit, synon t’u vijë në ndihmë prindërve që punojnë dhe të largojë fëmijët nga varësia ndaj ekraneve. Regjistrimet do të hapen në sistemin SMIP, pasi të ketë përfunduar formimi i klasave. Kërkesa do të paraqitet nga prindi, ndërsa qëndrimi i nxënësve në shkollë parashikohet të zgjasë të paktën deri në orën 15:00.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Pronat para viteve '91/ Kadastra hap aplikimin online, përfituesit dhe kush përjashtohet](#)

14:25 Sociale

[Njerëzit që pastrojnë Tiranën/ Flasin ata që punojnë kur të tjerët flenë: Nuk na lodh puna, por sjellja e qytetarëve](#)

13:40 Sociale / 7 komente

[Nis evidentimi dhe vlerësimi i dëmeve nga zjarret, Gogu: Ditë të vështira për shumë komunitete, mirënjohje forcave në terren](#)

12:35 Sociale

[Levani bëhet "zi", zjarret "përpijnë" 6 fshatra. Banorët me lot në sy](#)

21:45 Sociale / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.